



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-126

Prishtinë, më 23 shtator 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 23 SHTATOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletiq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sreten Ivanoviq, Albert Kinolli dhe Milivoje Stojanoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala;

Nga NDI-ja: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 16 shtator 2013,

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës:

2.1. Vazhdimi i seancës plenare, të filluar më 12 shtator,

2.2. Vazhdimi i seancës plenare, të filluar më 19 shtator,

2.3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht,

2.4. Procedimi i Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 shtator 2013

Nënkryetari i Kuvendit Sabri Hamiti theksoi se nuk ka vërejtje në procesverbal, në të cilin qëndron konstatimi i rezultatit të votimit (8 vota “për” dhe 6 vota “kundër”, me emrat e votuesve) për radhitje në rend dite të pikës ‘Votimi i raportit të Komisionit Qeveritar për privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së’, por ka vërejtje në substancë, meqenëse, sipas tij, të drejtë vote kanë pasur vetëm anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, e jo edhe kryetarët e grupeve parlamentare.

Me vërejtjen e nënkryetarit Sabri Hamiti, Kryesia e miratoi procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 shtator 2013.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Për vazhdimin e seancave plenare diskutuan: kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi; nënkryetari i Kuvendit Sabri Hamiti dhe kryetarët e grupeve parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Visar Ymeri, diskutimet të cilëve janë dhënë të plota transkript.

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare t'i vazhdojë punimet të enjten, më 26 shtator 2013, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Formimi i Komisionit ad hoc për shqyrtimin e aplikacioneve lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së,
2. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BZHKE,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Institutin e Kosovës për Administratë Publike,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-102,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës, ose të Panelit për Lirim me Kusht,
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012,
9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore,
10. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për zgjedhjen e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

2.1 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës, ose të Panelit për Lirim me Kusht

Kryesia e radhiti projektligjin e lartshënuar në rend dite për mbledhjen plenare më 26.9.2013.

2.2 Procedimi i Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij

Kryesia, lidhur me projektligjin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të japë mendim lidhur me Projektligjin për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, i hartuar nga grupi i deputetëve nënshkrues.
2. Kërkohet nga Ministria e Financave që të bëjë verifikimin e ndikimit buxhetor të këtij projektligji.

3. Qeveria e Kosovës duhet ta paraqesë mendimin e vet me shkrim në afatin prej një muaji nga dita e pranimi të Projektligjit, së bashku me Deklaratën për verifikimin e ndikimit buxhetor. Pas kalimit të këtij afati, projektligji procedohet në Kuvend për shqyrtim.

Pikat shtesë:

1. Propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryesia, pas shqyrtimit të propozimit të lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që, në pajtim me nenin 100.4 të Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Kosovë, t'i caktojë tre gjykatës për anëtarë të organit përzgjedhës të pavarur, që do të emërohen nga Kuvendi, për përzgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

2. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Personat e Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore

Kryesia e radhiti shqyrtimin e raportit të lartpërmendur në rend dite për mbledhjen plenare më 26.9.2013.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale